



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:089404

Datë: 31.07.2024

Numri i dokumentit: 06000856

KPPP.nr.527/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Vip Mobilje” SH.P.K., me NUI: 811050872, me seli në Gjilan, Magjistratja Gjilan - Prishtinë, përfaqësuar sipas autorizimit nga Liman Musa, avokat nga Gjilan, kundër debitorit “Inno Home” SH.P.K., me NUI: 811875840, me seli në Graçanicë, rruga “Stevana Perica” nr.38, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.607/24 të datës 26.02.2024, të Përmbartuesit Privat Argjent Xheladini, me seli në Gjilan, jashtë seancës me datës 31.07.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit “Inno Home” SH.P.K., i ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.607/24 të datës 26.02.2024, të Përmbartuesit Privat Argjent Xheladini.
- II. MBETET NË FUQI Urdhri Përmbartimor P.nr.607/24 i datës 26.02.2024, i Përmbartuesit Privat Argjent Xheladini.
- III. URDHËROHET debitori “Inno Home” SH.P.K., që në rast të parashtrimit ankesës, të deponoj në llogari të veçantë të “Këshillit Gjyqësor të Kosovës” nëpërmjet arkës së Gjykatës Themelore në Prishtinë, garancionin në shumën prej 340.00 € (tre qind e katërdhjetë euro), në afat prej 7 (shtatë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi.
- IV. Nëse debitori nuk e deponon garancionin brenda afatit të caktuar, ankesa e ushtruar kundër këtij aktvendimi, do të konsiderohet se nuk është dorëzuar fare nga pala ankuese.

A r s y e t i m

Përmbaresi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Vip Mobilje” SH.P.K., ka lëshuar urdhër me të cilin e ka lejuar përmbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm Faturës Nr. 16/23 të datës 13.04.2023, me të cilin ka detyruar debitorin që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimi të këtij urdhri kreditorit t’ia paguaj borxhin në shumën prej 340.00 €, me kamatë ligjore 8%, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm ashtu që përmbarimi të bëhet përmes bllokimit të llogarive bankare të debitorit, si dhe me regjistrimin, konfiskimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme në pronësi të debitorit deri në arritjen e borxhit në tërësi.

Kundër urdhrit për lejimin e përmbarimit, brenda afatit ligjor debitori ka paraqitur prapësim në të cilin ndër të tjerash ka theksuar se propozimi për përmbarim është në kundërshtim me dispozitat ligjore të LPP-së. Tutje ka shtuar se fatura e cila është objekt i kësaj procedure përmbarimore nuk i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm pasi që e njëjta nuk përmban vulën e debitorit, e njëjta përmban vetëm nënshkrimin e që nuk dihet se nga kush është pranuar, po ashtu i njëjti nuk ka paraqit deklaraten me shkrim për arritjen e kërkueshmërisë së borxhit. I ka propozuar gjykatës që ta aprovoi prapësimin e debitorit, si dhe ta ndërpres procedurën përmbarimore.

Kreditori përmes përfaqësuesit të autorizuar, brenda afatit ligjor ka parashtruar përgjigje në prapësim, duke theksuar se e kundërshton në tërësi prapësimin e debitorit, sa i përket pretendimit se fatura nuk i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm, e njëjta nuk qëndron pasi që fatura i plotëson të gjitha elementet të cilat kërkohen me ligj, ndërsa sa i përket pretendimit se kreditori nuk ka dorëzuar me shkrim deklaraten për arritshmërinë e kërkesës i njëjti përmes email-it e ka kërkuar borxhin ndaj debitorit. I ka propozuar gjykatës që ta refuzoj prapësimin e debitorit, ndërsa urdhrin përmbarimor ta lë në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, e duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura në bazë të cilës është lejuar urdhri për përmbnim, i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmban të gjitha elementet e kërkuara, në përputhje me nenin 29 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbnimit me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbnim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbnim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”* dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm, sipas të cilit mund të caktohet përmbnimit për realizimin e kërkesës në të holla.

Në rastin konkret gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbnuesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm përkatësisht Faturën Nr. 16/23 të datës 13.04.2023, e cila i përmban të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në këtë faturë, janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara mallrat të cilat kanë qenë objekt i faturës, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, koha e përmbushjes së detyrimit, si dhe e njëjta është pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, e cila vërtetohet nga nënshkrimi i debitorit.

Rrjedhimisht, gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura e lartcekur i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP, për zbatimin e përmbnimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që e njëjta është dorëzuar në origjinal, mbanë nënshkrimin e pranimit të debitorit, si dhe nuk është kontestuar nga debitori.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata lidhur me këtë çështje përmbnimore, vlerëson se nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbnimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 par.1 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Në pikën III të dispozitivit të këtij aktvendimi, gjykata ka urdhëruar debitorin, në rast të parashtrimit të ankesës të deponoj garancinë në gjykatë, në shumën e përcaktuar si në këtë pikë të dispozitivit të këtij aktvendimi dhe gjykatës t'ia dorëzoj provën për pagesën e garancionit, konform dispozitës ligjore të nenit 78 par.2 dhe 4 të LPP-së.

Nga arsyet e paraqitura më lartë, dhe duke u bazuar në nenin 73 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.527/24, datë 31.07.2024

Gjyqtarja

Verona Dibra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.